REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MIRDITË**

**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 639/3 Prot                                                                 Rrëshen, më 26.03.2026

**V E N D I M**

**Nr. 17 datë 19. 03. 2026**

**PËR**

**"PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE",**

**BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, "Për miratimin e buxhetit 2026", VKB nr. 98, datë 10.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", *Kërkesën nr. 639 prot, datë 05.02.2026, relacionin nr. 639/1 prot, datë 13.02.2026, "Mbi vlerësimin ekonomik - social të familjes të Znj. Vida Ndoc Ndrejaj", nga sektori i Ndihmës Sociale të Bashkisë,* së bashku me projektin-vendimin e Kryetarit Bashkisë, *shqyrtimin e miratimin, në mbledhjen e datës 18.03.2026, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit,* për t'a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, *në shumën **50 000** (pesëdhjetë mijë) lekë*, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;

- T'i akordojë ndihmë financiare, Znj. Vida Ndoc Ndrejaj me ID; H15429024O, njësia administrative Rrëshen, për kushte të vështira jetese

    a. **Paksim:** Fondi rezervë; (A1133 00 2133001 01 V491AAA..604) në vlerën;..**50 000** lekë

    b. **Shtohet:** Pagesë; (AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;..........**50 000** lekë

2. Pagesa të kalojë, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, (Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave)

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!*

**S E K R E T A R**

**Gaspër TOPOLLAJ**

**K R Y E T A R**

**Aleksandër PICAKU**

BASHKIA MIRDITË - REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPERISE

**BASHKIA MIRDITË**

**KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË**

Nr639/prot /2 Rreshen me 18/02/2026

**Nr. 18 date. 18.02.2026**

"PËR PERDORIM FOND REZERVE "

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", 87/2025, "Per buxhetin e vitit 2026" "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.2, datë.14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", ,ne VKB nr.98 datë 10.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", në kerkesen , nr.639/1 prot, datë.13.02.2026, te AASNS, "Kerkese per ndihme financiare", këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkise;

**V E N D O S I:**

***I-Të perdorë nga fondi Rezerve shumën 50 000 lekë, për dhënie ndihmë financiare si më poshte;***

1.Të japë ndihmë financiare zj.Vida Ndoc Ndrejaj (H15429024O), banuese Rreshen , NJA Rreshen, per kushte te veshtira jetese.

**a-Paksim**:fondi rezervë ( AI133 00 2133001 01 V491AAA..604) për shumën ***50 000/lekë***

***b-Shtohet*** (AA133 00 2133001 01 V111AAA......606) për shumën ***50 000/lekë***

.2. Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, zyra Postare Rreshen .

***II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksave.***

***III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.***

**SEKRETARI**
**Gaspër TOPOLLAJ**

**KRYETARI**
**Aleksander PICAKU**

**Paraqiten projektin**

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

Dr.Juridike, prok, protokoll: M.Topollaj

**KRYETARI**
**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.al

Financa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MIRDITË**

**AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE**

SEKTORI NDIHMËS SOCIALE

Nr.639/1 Prot. Rrëshen, më 13.02.2026

**Lënda:** Relacion

Drejtorisë së Financës

Bashkia Mirditë

Lidhur me kërkesën për ndihmë financiare, e ardhur në Bashkinë Mirditë më 05.02.2026, me nr.prot 639, dërguar nga zj.Vida Ndrejaj, drejtuar për trajtim Agjencisë A.S.N.S, po ju japim relacionin si më poshtë:

Shtetësja Vida Ndoc Ndrejaj, e lindur në Pllan – Lezhë, më 29.04.1971, me NID H15429024O, banuese në Rrëshen, është e vejë dhe jeton me dy vajzat e saj, të moshës 19 dhe 14 vjeçe. Vajza e madhe është me aftësi ndryshe, e diagnostikuar me Prapambetje të rëndë mendore dhe Çregullim të spektrit autik dhe trajtohet me kemp, ku përfiton shumën prej 14 930 (katërmbëdhjetëmijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë në muaj dhe kujdestari përfiton shumën prej 11 944 (njëmbëdhjetëmijë e nëntëqind e dyzet e katër) lekë në muaj. Kjo familje është gjithashtu përfituese e ndihmës ekonomike, ku përfiton shumën prej 7228 (shtatëmijë e dyqind e njëzet e tetë) lekë në muaj. Të ardhurat totale të familjes arrijnë gjithsej shumë prej 34 102 (tridhetë e katërmijë e dyqind e dy lekë) në muaj.

Nga analiza e të ardhurave mujore të familjes rezulton se burimet financiare janë të kufizuara dhe nuk arrijnë të përballojnë në mënyrë të qëndrueshme koston reale të jetesës. Pas përballimit të shpenzimeve bazë si ushqimi, energjia elektrike, uji, detyrimet e tjera mujore dhe nevojat arsimore të fëmijëve, të ardhurat e mbetura janë minimale dhe të pamjaftueshme për të garantuar një standard jetese dinjitoz.

Rritja e vazhdueshme e çmimeve të produkteve ushqimore dhe shërbimeve bazë ka ndikuar drejtpërdrejt në përkeqësimin e gjendjes ekonomike të familjes. Mungesa e një figure kontribuese

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

si pasojë e ndarjes nga jeta të bashkëshortit ka rënduar më tej situatën financiare dhe emocionale të familjes.

Familja përballet me vështirësi reale në menaxhimin e shpenzimeve mujore, duke qenë shpesh e detyruar të reduktojë shpenzimet edhe për nevoja thelbësore. Në këto kushte, si Shërbim Social, duke e njohur mirë realitetin e kësaj familje, e konsiderojmë të nevojshme dhënien e një mbështetjeje financiare për këtë familje.

**Konceptoi:** Adela Gjikola

**Konfirmoi:** Përgjegjës i Sekt.Soc. Gjergj Përgjoni

**Miratoi:** Drejtori Aurel Çupi

Nr. 639 Prot
Dt. 05.02.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
SEKRETARIA

Rreshen, më 05.02.26

# KËRKESË / ANKESË

Unë i/e nënshkruari/a Vida Ndrejaj, banues/e në Rreshen, me numër ID H 154290240 paraqes kërkesën/ankesën time si më poshtë vijon:

Kam gocen me aftesi ndryshe, ka qen trajtu me kemp. ka 3 muaj ja kan heq një pjese. Duke qen qe jemi në kushtë te veshtina pasi jam e vetme që po rris dy femi e kam shumë të veshtin të pen balloj shpenzimet.

Ju lutem merrni parasysh kërkesen time

Me respekt

Vida Ndregaj

0686946969